

PKR.567/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale me kryetaren e trupit gjykues Suzana Çerkini, dhe anëtarët Shpresa Hasaj-Hyseni dhe Arben Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurve F.L – K nga Prishtina, B.S nga fshati B. Komuna Prishtinë, I.Sh nga fshati B. Komuna Prishtinë, F.S nga fshati B. Komuna Prishtinë, A.G nga fshatin D. Komuna Prishtinë, B.B - Ç nga fshati Ll. Komuna Komuna Podujevë dhe B.K nga Prishtina, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I, nr.91D/2013 të datës 25.09.2015, pas shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 06.03.2018 me praninë e Prokurorit të shtetit Besa Limani dhe të akuzuarve F.L - K, B.S, I.Sh, F.S, A.G, B.B - Ç dhe B.K, të njëjtën datë, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

1. F.L-K, e bija e F., dhe nënës M. e vajzërisë D., e lindur me..., në P. ku edhe tani jeton rr."U" Kompleksi /, ka të kryer fakultetin Ekonomik, e pa punë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës. E identifikuar me LNJ të RKS me numër personal..,

2. B.S, i biri i F, dhe nënës N. e vajzërisë K., i lindur me ..., në fshatin B. Komuna P, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punon si tregtar, i martuar babë i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

3.I.Sh, i biri i Sh, dhe nënës F. e vajzërisë D., i lindur me ..., në fshatin B. Komuna P, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën- akademin policore, tani pensionist, i martuar babë i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal...

4.F.S, i biri i T. dhe nënës Gj. e vajzërisë Sh, i lindur me ..., në fshatin B. Komuna P., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme –teknik i xehtarisë, i martuar babë i 4 fëmijëve, punon në KEK, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

5. A.G, i biri i I, dhe nënës F. e vajzërisë A, i lindur me ..., në fshatin D. Komuna P, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punon në ndërtimtari, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës. I identifikuar me LNJ të RKS me numër personal.,

6. B.B - Ç, e bija e E, dhe nënës Sh. e vajzërisë I., e lindur me..., në P, me vendbanim në fshatin LI KK P., ka të kryer shkollën e mesme, studente, e pa punë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës, e identifikuar me LNJ të RKS me numër personal...,

7. B.K, e bija e H, dhe nënës Z e vajzërisë B, e lindur me ..., në fshatin M. Komuna P, me vendbanim në P. lagj. "D" rr. " ", Hyrja, nr, ka të kryer shkollën e mesme, punon në Komunën e Prishtinës, e martuar, nënë e tre fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare – shtetase e Republikës së Kosovës, e identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ,

JANË FAJTOR

Sepse, me datë 12.12.2010 gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në qendrën e vendvotimit nr.1934E/02R, në shkollën fillore "Ali Kelmendi" në fshatin Barilevë, të pandehurit F.L- K, B.S, I.Sh, F.S, A.G, B.B - Ç dhe B.K, në bashkryerje kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve apo votimeve në Kosovë, në atë mënyrë që në rastin e numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike kanë hequr votat disa kandidatëve dhe kanë shtuar kandidatë tjerë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 764 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) vota, dhe atë nga kandidatët e subjektit politik FER 11(një) votë, KDTP 3 (tri) vota, AKR 11(njëmbëdhjetë) vota dhe PDK 486 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) vota,

- me çka kanë kryer veprë penale në bashkëryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11, 15, 34, 41,42,43, 44,45,64,66 par.2, 67 par.1 nënpar.5 të KPK, si dhe neneve 326, 357, 359, 365, 366 të KPP u shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që secilit të akuzuar i përcakton:

1. F.L. K, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
2. B.S, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
3. I.Sh, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
4. F.S dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
5. A.G, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
6. B.B, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale,
7. B.K dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale

Të akuzuarit bashkërisht obligohen t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor secili veç e veç në shumë prej nga **30 (tridhjetë)** euro, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën 91D/2013 të datës 25.09.2015a akuzuar F.L- K, B.S, I.Sh, F.S, A.G, B.B - Ç dhe B.K për vepër penale Mashtrimi në votime në bashkëkryerje nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 24.11.2017, në të cilin të gjithë të akuzuarit mohuan fajësinë për veprën penale për të cilën

akuzohen, duke theksuar se nuk dëshirojnë të paraqesin kundërshtim të provave por dëshirojnë që kjo çështje gjyqësore të procedohet drejtpërdrejt në shqyrtim kryesor. Andaj gjykata vazhdoi procedimin e çështjes në fazën e mëtejme të shqyrtimit kryesor me administrimin e provave.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datën 06.03.2018, të akuzuarit e lartcekur duke qenë të gjithë të vënë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht pranuan në tërësi fajësinë për veprën penale që u vihet në barrë me aktakuzë, andaj gjykata nuk patinevojë të procedojë me administrimin e provave, përkatësisht me dëshminë e dëshmitarit të ftuar si përfaqësues i Komisionit Qendror Zgjedhor.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga të akuzuarit duke konsideruar se edhe gjykata do duhej t'a pranojë sepse ky pranim është bërë në bazë të vullnetit të lirë të akuzuarve, pa presion dhe duke qenë secili i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e po ashtu ky pranim është në përputhshmëri me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Pas deklaramentit të të akuzuarve se, ndihen fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen dhe, pajtimin për pranimin e fajësisë së të akuzuarve nga prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuzën dhe aktakuzën nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, siç parashihet në nenin 248 tëKPP.

Në vazhdim, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare theksoi se mbetet në tërësi pranë akuzës, meqë në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, se të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar e që ishte objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor. Ka theksuar se kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprën për të cilën ngarkohen e cili pranim është në përputhshmëri me provat e mbledhura nga kjo prokurori që nga faza e hetimeve. Andaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit dhe gjatë matjes së dënimit të marrë parasysh të gjitha rrethanat e parapara me ligj e sidomos faktin se të gjithë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprën për të cilën janë akuzuar në aktakuzë.

Në fjalën përfundimtare të akuzuarit u deklaruan secili ndaras, duke theksuar individualisht se kjo kaqenëhera e çarëtëkenëkryer veprën penale, janë penduar dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të presërisin asnjëherë veprën të tillë apo të ngjashme penale, në fund secili ka lutur gjykatën për dënim sa më të butë.

Gjykata, pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga të akuzuarit, vlerësimi të rrethanave të rastit në fjalë dhe të theksuarave në fjalët përfundimtare të palëve, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban aktakuzën, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e secilit të akuzuar formësohen elementet e figurës së veprës penale që u vihet në barrë të njëjtëve, andaj pasi që më parë gjeti se të gjithë të akuzuarit janë penalisht përgjegjës, i shpalli fajtor për veprën penale Mashtrimi në votime

në bashkëkryerje nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, u shqiptoi dënim të paraparë ligjor, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanat lehtësuese: për secilin të akuzuar pati parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e shprehur për veprën e kryer si dhe premtimet e dhëna se nuk do të përsërisin asnjëherë veprën të tillë apo të ngjashme penale, kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale dhe faktin se anjëherë tjetër nuk kanë përsëritur veprime të kundërligjshme të kësaj natyre, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti për asnjërin nga të akuzuarit, andaj në aplikim të dispozitave të zbutjes së dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, në bazë të nenit 66 par.2 dhe 67 par.1 nënpar.5 të KPK, secilit i përcaktoi dënim burgimi të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarve, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtëve, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK dhe, në fund me bindje se të pandehurit në të ardhmen nuk do të përsërisin veprën tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.567/15, me datë 06.03.2018**

Sekretarja juridike
Albulena Ademi

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja
Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.